



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:238936  
Datë: 09.08.2023  
Numri i dokumentit: 04570672

**C-IV-14-1937**

*Ankuesi*

S A Istog

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 07 gusht 2023 lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ137-0044, i datës 12 shkurt 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 24 mars 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PEJ137-0044, të datës 12 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilin ka kërkuar kompensimin për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 1,855.00 €, nga NSH “Korenik” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se me datën 25 shkurt 2014, ka pranuar vendimin për dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga kryesia e autoritetit të likuidimit. Gjithashtu ankuesi kërkon që të më paguhen gjashtë pagat, ndërsa AL-ja mi ka paguar vetëm tri paga, me arsyetimin se unë i paskam 18.05 vite përvojë në punë në NSH. Ky konstatim për mu është i papranueshëm, pasi që unë i kam 24.03 vite e shtatë ditë punë, prandaj i drejtohem Dhomës së Posaçme për rishikimin e vendimit të AL-së.

Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar: librezën e punës, formularin për parashtrimin e kërkesës në AL, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në proces të likuidimit si dhe vendimin e kundërshtuar të AL-së.

Me 25 tetor 2021, e paditura AKP ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL dhe se në këtë kontest neni 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesa e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimit të AL duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04-L-034 për AKP. Po ashtu e paditura pohoi se pretendimet e ankuesit janë edhe të pa bazuara. Në përgjigje në ankesë AKP-ja thotë se ankuesi e ka marrë kompensimin për dëmshpërblim për 18.5 vite përvojë pune, kështu që ankuesi është shpërblyer me tri paga, për aq kohë sa ka punuar, andaj AKP-ja mbetet pranë vendimit të marrë dhe kërkon nga Dhoma që vendimi i AL-së të mbetet në fuqi.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në pajtim me nenet 2.4 dhe 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 76.7. të Ligjit të punës, të datës 01 nëntor 2010, Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;  
dhe
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore.

Që me këtë dëshmohet me së miri se ankuesi është shpërblyer për punën e tij nga AKP-ja me tri paga bruto të paguara për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. kjo më së miri shihet në nenin e më sipërm në pikën 7.3. Ankuesi thekson se më takojnë gjashtë paga, por për këtë nuk ka prova as bazë pasi që i ka përvojë pune vetën 18.5 vite, e jo 24.3 siç pretendon ankuesi. Prandaj AKP-ja në këtë rast ka vepruar saktë dhe drejt me vendimin e marrë.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtresat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e të ardhurave personale, për kompensim për dëmshpërblim.

Ankuesi nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi pranë Autoritetit të Likuidimit, si dhe në ankesën e ushtruar në Dhomën e Posaçme për të mbështetur pretendimin e tij për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 1.855.00 €, nga N.SH “Korenik” (në Likuidim). Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh pagat e kërkuara. Për më tepër ankuesi nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi për të mbështetur lartësinë e shumës së kërkuar, apo mënyrën e llogaritjes së shumës prej 1,855.00 €, edhe pse AKP-ja ia ka bërë pagesën ankuesin për dëmshpërblim në shumë prej 931.08 Euro, për dëmshpërblim për 18.5 vite punë, por ankuesi pretendon ti paguhen 1,855.00, për 24.3 vite punë, që në realitet për këtë nuk ka prova dhe bazë juridike.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP-së, duke u bazuar në nenin 40 të shtojcës së Ligjit për AKP-në, mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person.

Nga dispozita e lartë cekur, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar.

Ankuesi për më tepër nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi dëmshpërblimi e pretenduar nga ai ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të shtojcës së Ligjit për AKP-në, paragrafi 1.6 pika 1.6.1, por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër, ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

---

Diellza Hoxha  
Gjyqtare